



Deri: Të gjithë SHTR TV serviset programore

Për: Drejtorin

Lënda: Informacion për obligimet të cilat dalin nga Ligji për media dhe Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele

Të nderuar,

Nga data 3 janar të vitit 2014 në fuqi hyjnë Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe Ligji për media („Gazeta zyrtare e RM-ës “ nr. 184/2013).

U njoftojmë se Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, si pasues ligjor i Këshillit të radiodifuzionit, sipas detyrimit zyrtar do të realizojë ndërrimin e lejeve të deritanishme për ushtrim të veprimtarisë radiodifuzive me leje të reja për radio emetim në afat prej 30 ditëve nga dita e sjelljes së vendimit për zgjedhje të Drejtorit të Agjencisë. Leja e re do të vlejë nëntë vite që nga dita e marrjes së sajë.

Tekstet e të dy Ligjeve do të publikohen në ueb faqen e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (www.avmu.mk), Më poshtë në shkrim ju informojmë për detyrimet të cilat serviset programore televizive do ti kenë në pajtueshmëri me këto dy Ligje. Disa nga këto detyrime janë të njëjta si ato të deritanishmet, disa janë të modifikuara (të ndryshuara), ndërsa disa janë të reja:

- Emërimi i redaktorit përgjegjës (neni 8 nga Ligji për media);
- Publikimi i informacioneve për emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së emetuesit të medias, bartësit e të drejtave të autorit, datën dhe origjinën e produksionit në vend të duhur për çdo përmbajtje të transmetuar (neni 14 nga Ligji për media);
- Sigurimi i publikut në punën nëpërmjet publikimit të të dhënave për strukturën pronësore, redaktorët përgjegjës, burimet e financimit, të ardhurat dhe shpenzimet mesatarisht nga dëgjimi (neni 15 nga Ligji për media);
- Dorëzimi i raportit në formë të shkruar deri tek trupi rregullator në të cilën do të tregohet zbatimi i obligimeve të përcaktuara në lejen për emetimin e programit, veçanërisht në koncept programor, një herë në vit, më vonë deri më 31 mars në këtë vit (Neni 15 nga Ligji për media);
- Publikimi i korrigjimeve respektivisht përgjigje e informatës së publikuar (nenet 18, 19, 20, 21, 23 dhe 27 nga Ligji për media);
- Mundësim pa ndërprerë mbikëqyrje nga ana e personave të autorizuar nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Neni 33 nga Ligji për shërbime mediatike

Nr _____

Shkup _____ viti
2014.



**Agjencia për
shërbime mediatike
audio dhe
audiovizuele**

**Bul. VMRO nr.3
1000 Shkup
Republika e
Maqedonisë**

Tel. (02) 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact @avmu.mk**



audio dhe audiovizuele);

- Respektimi i rregullave për mbrojtjen e pluralizmit dhe të shumëllojshmërisë të strukturës së shërbimeve mediatike (Neni 34 dhe 43 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Evidencë e përditshme të programit të transmetuar dhe ta incizojnë sinjalin dalës të programit të vet, (Neni 47 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Sigurimi se shërbimet mediatike nuk do të mbajnë programe me të cilat rrezikohet siguria nacionale, nxitet rrënimi i dhunshëm i rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thiret në agresion ushtarak ose në konflikt të armatosur, nxitet ose përhapet diskriminimi, mosdurimi, ose urrejtja në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit. (Neni 48 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i marrëveshjeve me poseduesit e të drejtave për emetimin e veprave kinematografike (Neni 49 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Sigurim se shërbimet mediatike nuk do të emetojnë programe që mund seriozisht ta dëmtojnë zhvillimin fizik, psikik ose moral të personave të mitur, veçanërisht programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të panevojshme dhe respektim i masave teknike të përcaktuara nga Agjencia e brojtjes së të miturve (Neni 50 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Sigurim i drejtpërdrejtë dhe qasje të përhershme e shfrytëzuesve deri tek të dhënat për emrin, shenjën mbrojtëse, shenjën e identifikimit, adresën e selisë dhe të dhënat për realizimin e kontaktit me dhënësin e shërbimit, derisa ajo është e mundur edhe të dhëna për trupin rregullator të caktuar (Neni 51 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektim i rregullave të caktuara nga Agjencia për emetimin e kuizeve dhe programe të tjera në të cilat premtohet shpërblime (Neni 52 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektim i rregullave të përgjithshme për emetimin e komunikimit komercial audiovizuel (Neni 53 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektim i rregullave për sponsorim (Neni 54 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i rregullave për pasimin e prodhimeve në programe (Neni 55 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i parimeve për emetimin e programeve (Neni 61 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i rregullave për përdorimin e gjuhës (Neni 64 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Sigurim më pakë 80% nga koncepti programor për të cilën është lëshuar leje për emetim (Neni 67 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i rregullave për emetimin e ngjarjeve me domethënie të madhe (Neni 87 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);



- Respektimi i rregullave për informimin e shkurtë të ngjarjeve për të cilat ekziston interesim i lartë tek publiku, ndërsa për të cilat të drejtat ekskluzive për emetim i kanë radiodifuzerët e tjerë (Neni 89 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i obligimeve për kohëzgjatjen minimale të emetimit të përditshëm (Neni 90 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i për emetimin e Veprave evropiane audiovizuele dhe vepra nga producent të pavarur nga ana e serviseve programore televizive në nivel të shtetit (Neni 91 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Radiodifuzerët mund të shfrytëzojnë shërbime telefonike me vlerë të shtuar, duke përfshirë edhe votimin telefonik në programet në të cilat ajo është e lejuar në pajtueshmëri me rregullat të caktuara nga Agjencia (Neni 93 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Emetimi i lojërave të fatit të organizuara vetëm nga subjektet me licencë nga organi kompetent shtetëror për organizimin e e lojërave të fatit. Respektim i ndalimit, Servisi publik radiodifuziv në programet e veta nuk mund të organizojë dhe të emtojë lojëra të fatit me vënie bast në gara sportive. (Neni 94 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Lidhja në sistemin unik për emetimin të programit të përbashkët vetëm pas njoftimit të dorëzuar paraprakisht në Agjenci, por jo më gjatë se 4 orë gjatë 24 orëve, me koncept programor për program të përbashkët, emërimi i redaktorit përgjegjës dhe paraprakisht duke e njoftuar Agjencinë (Neni 95 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Identifikimi qartësisht i reklamimit dhe teleshoppingut nga pjesët e tjera të programit. (Neni 98 Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i rregullave për mënyrën e emetimit të reklamimit dhe teleshoppingut, të rregullave të futjes në programe dhe të ndalimit të emetimit reklamim dhe teleshopping në llojet konkrete të programeve (Neni 99 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Kohëzgjatja e reklamimit dhe spoteve të teleshoppingut në programet e radiodifuzerëve, përpos për servisin publik të radiodifuzionit, nuk guxon të jetë më shumë se 12 minuta për një orë reale. Në këtë kohë nuk hyjnë paralajmërimet në programin e tij, paralajmërimet për sponsorim dhe plasman të prodhimeve, si dhe njoftimet me interes publik dhe apelet për qëllime humanitare që radiodifuzeri do ti transmetojë pa pagesë (Neni 100 Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Në reklama dhe në teleshopping nuk mund të shfaqen në mënyrë vizuale ose me zë personat të cilët rregullisht prezantojnë lajme dhe emisione informative aktuale (Neni 101 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele).

Veçanërisht ua bëjmë me dije të keni kujdes në dispozitat të cilat sillen për mbrojtjen dhe përkujdesjen e identitetit kulturor:

- Radiodifuzerët janë të obliguar që në ditë të emetojnë së paku 30% program burimor të krijuar në Republikën e Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë duke filluar nga viti 2014. Prej vitit 2015, obligimi prej 30% rritet në 40%. Prej vitit 2016, obligimi prej 40% rritet në 50%. Radiodifuzerët janë të obliguar që së paku gjysmën e përqindjes nga obligimet të këtij neni, ta realizojnë në periudhën prej orës 7 deri në orën 19. (Neni 92 paragrafet 1, 3 dhe 12 od Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);



- Emetim më pakë 8 orë muzikë vokale dhe/ose vokale instrumentale në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë gjatë tërë javës nga ana e serviseve programore televizive në format të përgjithshëm e cila 50% duhet të jetë argëtuese muzikë vokale dhe/ose vokale instrumentale, e 50% muzikë popullore vokale dhe/ose vokale instrumentale dhe së paku gjysmën e obligimit për muzikë të përcaktuar dhe të këtij neni ta realizojnë në periudhën prej orës 7,00 deri në orën 19,00. (Neni 92 paragrafi 4 dhe 6 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Prodhim vjetorë më pakë 10 orë program dokumentar vendordhe më pakë 20 orë program artistik vendas nga ana e serviseve televizive në format të përgjithshëm që emetojnë program në nivel të shtetit dhe emetimin e tyre në periudhë prej ora 7:00 deri në ora 19:00 (Neni 92 paragrafët prej 8 deri 11 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);

Me respekt,

**Agjencia për shërbime mediatike audio dhe
audiovizuele
Kryetari,**

Dr. Zoran Trajčevski